

L I G J
Nr.8450, date 24.2.1999

PER PERPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTAES,
TE GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës me propozimin e Këshillit te Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shteti përcakton politiken e zhvillimit te veprimtarive ne fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit te naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator, ne përputhje me nevojat e vendit, te mbrojtjes kombëtare dhe te sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë se tregut.

Neni 2

Ne zbatim te këtij ligji, ministria, qe mbulon veprimtarinë e hidrokarbureve, është përfaqësuese e shtetit ne fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit te naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre.
Për ndjekjen dhe realizimin e dispozitave te këtij ligji, si dhe te ligjit nr.7746, date 28.7.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), me ndryshimet përkatëse, ne ministri funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve.

Neni 3

Dispozitave te këtij ligji u nënshtrohen, pa asnjë dallim, te gjithë personat juridike, publike ose private, vendas apo te huaj, qe kane si objekt te veprimtarisë se tyre përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre.
Përjashtimisht, Këshilli i Ministrave u jep personave juridike te caktuar, disa funksione apo kompetenca qe i përkasin sektorit publik dhe qe lidhen me zhvillimin e veprimtarive, objekt i këtij ligji.

Neni 4

Ushtrimi i veprimtarive ne fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit te naftës, gazit e nënprodukteve te tyre behet vetëm nga persona juridike, pasi te jene pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve te këtij ligji. Ne mungese te këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme.

Neni 5

Ushtrimi i veprimtarive të parashikuara në këtë ligj i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 6

Importimi dhe eksportimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre bëhet lirisht, nga dhe në cilindo shtet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të kësaj fushe, ku shteti ynë është pale, duke respektuar dobinë ekonomike.

Neni 7

Këshilli i Ministrave ka kompetencë liberalizimin e çmimeve të shitjes me pakice të nënprodukteve të naftës dhe të gazit. Në situata të veçanta tregu, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kufizime të përkohshme (çmime tavan apo dysheme) për çmimet e shitjes me pakice të nënprodukteve të naftës e të gazit.

Neni 8

Personat juridike, që ushtrojnë veprimtari në përputhje me këtë ligj, janë të detyruar të paraqesin në ministri informacion për programin e zhvillimit, si dhe të dhënat periodike, që lidhen me realizimin e veprimtarisë së tyre. Lloji i të dhënave dhe informacionit, forma dhe afatet e dërgimit të tyre, nga personat juridike, përcaktohen nga ministri. Ministria përgjigjet për përpunimin dhe publikimin e këtij informacioni, duke përcaktuar formën, afatet dhe mënyrën e botimit.

Neni 9

Rezerva e sigurisë

1. Për mbulimin e nevojave të konsumit kombëtar në periudha krize dhe situatash të jashtëzakonshme brenda territorit të vendit, **rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumice janë të detyruara të mbajnë rezerva sigurie**. Këshilli i Ministrave përcakton kategoritë e naftës dhe të nënprodukteve të saj, për të cilat duhet mbajtur **rezerva e sigurisë**.
2. Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumice të naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre janë të detyruara të mbajnë **rezerva sigurie**, të barabarta me 30 dite mesatare shitjeje, sasi që llogaritet duke u mbështetur në të dhënat dhe rezultatet faktike të veprimtarisë së vitit të mëparshëm.
3. Sasia e rezervës së sigurisë, që detyrohet të mbaje çdo rafineri naftë dhe çdo shoqëri tregtimi me shumice, përcaktohet sipas kritereve të mësipërme, me urdhër të ministrit. Drejtoria e përgjithshme e hidrokarbureve përgjigjet për kontrollin e sasive të rezervës së sigurisë në të gjitha subjektet. Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumice detyrohen të plotësojnë sasinë përkatëse të rezervës së sigurisë, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Rafineritë e naftës, rezervën e sigurisë deri në 50 për qind të sasisë së saj, mund ta mbajnë edhe në formën e naftës bruto në rezervuarët e tyre apo në rezervuarët e shoqërive të prodhimit të naftës, me të cilat ato kanë kontrata furnizimi. Shoqëria e tregtimit me shumice rezervën e sigurisë e mban në **rezervuarët prone të shoqërisë apo të marra në përdorim prej saj në bazë të një kontrate**.

Neni 10

Ne kuptim të këtij ligji, nafta, gazi natyror dhe nënproduktet e tyre klasifikohen në kategori, si vijon:

Kategoria O

- A. Nafta bruto
- B. Gazi natyror

Kategoria I

- A. Gazi i lëngshëm

Kategoria II

- A. Benzine automjesh
- B. Benzine mjesh të fluturimit ajror
- C. Nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, white spirit.

Kategoria III

- A. Gazoil (Diezel)
- B. Vajguri ndriçues
- C. Lende djegëse për mjete të fluturimit ajror reaktive (kerozene)

Kategoria IV

- A. Vajrat
- B. Solare

Kategoria V

- A. Bitum (asfalt)
- B. Mazut

KREU II

PERSONAT JURIDIKE, QE USHTROJNË VEPRIMTARI TË PERPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË NAFTES, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Neni 11

Personat juridike, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:

- a) rafineri nafte, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit të naftës bruto;
- b) naftësjellës e gazsjellës, që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës bruto dhe të gazit natyror (kategoria O);
- c) shoqëritë e tregtimit me shumice, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumice të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete;
- d) njësitë e shitjes së lendeve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për ngrohje të konsumatoreve.

Neni 12

Rafineritë e naftës

- 1. Rafineritë e naftës janë persona juridike, te themeluara ne formën e shoqërive anonime, te cilat me marrjen e leje se koncesionit, kryejnë veprimtari ne përpunimin e naftës bruto, duke prodhuar nënprodukte te saj. Rafineritë e naftës për tregtimin e produkteve te tyre kane te drejte te formojnë shoqëri tregtimi me shumice te nënprodukteve te naftës apo te zotërojnë aksione ne një shoqëri te tille. Ne këto raste rafineritë e naftës duhet te respektojnë dispozitat lidhur me konkurrencën(shfuqizuar).*
2. Ndërtimi i rafinerive te reja te naftës behet vetëm me leje te posaçme te Këshillit te Ministrave, pasi te jete plotësuar paraprakisht dokumentacioni i përcaktuar nga ministria.
3. Rafineritë e naftës kane te drejte te përpunojnë nafte bruto te prodhimit te vendit ose me origjine nga importi. Ato kane te drejte te realizojnë marrëveshje për furnizimin me nafte bruto me shoqëri prodhuese te naftës, me naftësjellës, me shoqëri te tregimit me shumice, si dhe kane te drejte te realizojnë marrëveshje për importimin e naftës bruto.
4. Rafineritë e naftës kane te drejte t'i shesin prodhimet e tyre ne vend dhe për eksport.
5. Rafinerive te naftës u ndalohet te lidhin çfarëdo marrëveshje për furnizim te drejtpërdrejtë te stacioneve te shitjes se karburanteve, te njërive te shitjes se lendeve djegëse, te shoqërive qe tregtojnë me pakice apo shoqërive te papajisura me leje, sipas përcaktimeve te këtij ligji.
6. Rafineritë e naftës përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e nënprodukteve te naftës te prodhuara prej tyre.
7. Rafineritë e naftës përgjigjen për respektimin e normave te përcaktuara ne kete ligj, lidhur me rezervën e sigurisë.

Neni 13

Naftësjellësit, gazsjellësit

1. Naftësjellësit dhe gazsjellësit janë persona juridike te themeluar si shoqëri anonime, qe, ne baze te lejes se koncesionit, kane te drejte te realizojnë veprimtari te importimit, eksportimit dhe transportimit me ane te instalimeve te tyre te naftës bruto dhe gazit natyror, te vendit ose te importit, deri ne vendin përcaktuar te pranimit nga rafineritë e naftës ose shoqëritë e tregtimit me shumice. Instalimet e naftësjellësve dhe gazsjellësve përfshijnë linjat (tubacionet), rezervuarët e magazinimit (stokimit) dhe pajisjet e tjera, qe shërbejnë për transportimin dhe trajtimin e fluidit.
2. Ndërtimi i naftësjellësve dhe gazsjellësve për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto dhe te gazit natyror, behet me vendim te Këshillit te Ministrave.
3. Personat juridike, qe ushtrojnë veprimtari te prodhimit ne vend te naftës bruto dhe te gazit natyror, kane te drejte te ndërtojnë instalimet përkatëse dhe te ushtrojnë veprimtari te transportimit, ne përputhje me dispozitat e ligjit nr.7746, date 28.7.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi).
4. Transportimi i naftës bruto dhe i gazit natyror për import a eksport realizohet nëpërmjet kontratave qe sigurojnë furnizimin e vazhduar shumëvjeçar te konsumatoreve. Një kopje e këtyre kontratave, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes se saj, depozitohet ne Drejtorinë e Përgjithshme te Hidrokarbureve.

Neni 14
Shoqëritë e tregtimit me shumice

1. Veprimtaria e tregtimit me shumice të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të vendit të importit, ushtrohet nga **shoqëritë e tregtimit me shumice**. Përfshihen nga ky rregull bëjnë: a. **personat juridikë që prodhojnë hidrokarbure** në baze të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), të cilët kanë edhe të drejtën e tregimit të prodhimit të tyre; b. **rafineritë e naftës** të cilat do të tregtojnë prodhimet e tyre. Shoqëritë e tregtimit me shumice kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë ose në një pjesë të territorit të vendit. Këto shoqëri disponojnë impiante për depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera dhe përgjigjen për **funksionimin e këtyre impianteve, në përputhje me normat teknike të miratuara nga ministria dhe masat e Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ)**.
2. Tregtimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera ushtrohet vetëm nga **shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive anonime**, pasi të jenë pajisur me leje tregtimi, sipas dispozitave të këtij ligji.
3. Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri që ushtrojnë veprimtari si stacione të shitjes së karburanteve apo njësi të lendeve djegëse.
4. Shoqëritë e tregtimit me shumicë transportimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre bëjnë me naftës-jellës, në baze të **kontratës së transportit, të lidhur me to, me mjete transporti** hekurudhor, detar dhe tokësor, të cilat janë **të pajisura me licence**, në përputhje me ligjin nr.8308, datë 18.8.1998 "Për transportet rrugore". Këto mjete transporti mund të jenë prone e shoqërisë së tregtimit me shumicë ose mund të merren në përdorim prej tyre kundrejt pagesës. Shoqëria e tregtimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit.
5. Shoqëritë e tregtimit me shumicë janë të detyruara **të furnizojnë në mënyrë të pandërprerë impiantet e tyre dhe, njëkohësisht, të garantojnë furnizimin normal të kontraktoreve me produktet përkatëse**. Në zbatim të këtij detyrimi ato **duhet të mbajnë dokumentacion të veçantë sipas përcaktimeve të bëra nga ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për hidrokarburet**.
6. Shoqëritë e tregtimit me shumicë **e realizojnë veprimtarinë e tyre në tregun e brendshëm, si dhe eksportimin e importimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre** nëpërmjet **kontratës**. Kryerja e pagesave për importet dhe eksportet, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktore, si dhe çdo detyrim doganor e fiskal, që lidhet me këto shoqëri, bëhet nëpërmjet **dokumentacionit bankar**.
7. Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të furnizojnë me nënproduktet përkatëse të naftës dhe gazit mjetet detare dhe ajrore.
8. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për dërgimin në ministri në afatet e caktuara të informacionit të kërkuar prej veprimtarisë së tyre.
9. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për markën e produktit dhe cilësinë e nënprodukteve të naftës dhe gazit që tregtojnë. Ato kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll në stacionet e shitjes së karburanteve apo në njësitë e shitjes së lendeve djegëse të furnizuara prej tyre, me qëllim të garantimit të cilësisë së nënprodukteve të naftës dhe gazit, që u ofrohen konsumatorëve.
10. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për respektimin e normave të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rezervën e sigurisë.

Neni 15

Stacionet e shitjes se karburanteve

1. Veprimtaria e tregtimit me pakice te karburanteve, ku përfshihen nënproduktet e kategorisë I, II dhe III, te përcaktuara ne nenin 10 te këtij ligji, ushtrohet nga stacionet e shitjes se karburanteve.

Stacionet e shitjes se karburanteve janë persona juridike, qe themelohen ne një nga format e shoqërive te parashikuara nga legjislacioni tregtar.

Stacionet e shitjes se karburanteve lejohen te ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi te jene pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji, me kusht qe ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjate ushtrimit te veprimtarisë te jene ne përputhje me kushtet teknike te përcaktuara nga ministria.

2. Stacionet e shitjes se karburanteve janë te detyruara te furnizohen vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumice, te licencuara sipas këtij ligji, ne baze te kontratave te lidhura ndërmjet tyre.

3. Stacionet e shitjes se karburanteve, mbështetur ne llojin e marrëveshjes tregtare te bashkëpunimit me shoqëritë e tregtimit me shumice, klasifikohen si vijon:

- Stacione qe furnizohen ekskluzivisht nga një shoqëri tregtimi me shumice, te cilat janë te detyruara te mbajnë markën e saj tregtare. Këto stacione, për ekspozimin e markës se shoqërisë se tregtimit me shumice dhe për informimin e konsumatoreve, janë te detyruara te vendosin tabela te dukshme e te dallueshme qarte nga distanca. Deri ne përfundim te afatit te marrëveshjes tregtare te bashkëpunimit ekskluziv, përkatës, këtyre stacioneve u ndalohet te furnizohen me karburante te shoqërive te tjera te tregtimit me shumice, qofte drejtpërdrejt ose tërthoras;

- stacionet te quajtura te bardha, nuk kane veprimtari te mbështetur ne një marrëveshje tregtare bashkëpunimi ekskluziv me një shoqëri tregtimi me shumice. Këto stacione kane te drejte te mbajnë markën e tyre te posaçme tregtare. Rregullat për mbajtjen e një marke te posaçme përcaktohen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Stacioni i shitjes se karburanteve është i detyruar qe, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit, te depozitoje ne Drejtorinë e Përgjithshme te Hidrokarbureve një kopje te marrëveshjes tregtare te bashkëpunimit ekskluziv.

4. Stacioneve te shitjes se karburanteve u ndalohet te tregtojnë karburante për mjete transporti, detar e ajror, si dhe lende djegëse te lëngëta apo te gazta.

5. Ne çdo stacion te shitjes se karburanteve duhet te jene te ekspozuara, ne mënyrë te dukshme dhe te qarte llojet e karburanteve qe tregtojnë, çmimet e tyre, koha e punës dhe shërbimet e tjera qe kryhen nga stacioni.

6. Stacionet e shitjes se karburanteve përgjigjen për cilësinë e karburanteve, duke ruajtur për kete qellim edhe kampionet përkatëse te karburanteve, te furnizuara nga shoqëritë e tregtimit me shumice.

7. Ne çdo stacion te shitjes se karburanteve mbahet dokumentacioni, ne përputhje me normat e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve.

Neni 16

Njësitë e lendeve djegëse

1. Veprimtaria e tregtimit me pakice te lendeve djegëse për ngrohje për konsumatorët ushtrohet nga njësitë e lendeve djegëse.

Njësitë e shitjes se lendeve djegëse janë vetëm persona juridike, te themeluar ne njëren nga format e shoqërive te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

- Njësitë e shitjes se lendeve djegëse lejohen te ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi te jene pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës sipas këtij ligji.
- Njësitë e shitjes se lendeve djegëse u ndalohej te tregtojnë karburante për automjete, si dhe qe te ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë stacioneve te shitjes se karburanteve.
2. Instalimet e njësive te lendeve djegëse, qe përfshijnë pajisjet e depozitimit dhe ato te shitjes, dhe funksionimi i këtyre njësive duhet te jene ne përputhje me normat teknike te përcaktuara nga ministria dhe me rregullat e MNZ-se.
3. Njësitë e shitjes se lendeve djegëse janë te detyruara qe furnizimin e tyre ta bëjnë vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumice, te licencuara sipas këtij ligji. Ato përgjigjen për cilësinë e produkteve qe tregtojnë
4. Ne njësitë e shitjes se lendeve djegëse duhet te jene te ekspozuar informacioni për llojet e lendeve djegëse për ngrohje qe tregtojnë, çmimet e tyre, koha e punës dhe shërbimet e tjera qe kryhen nga njësia.

KREU III

LEJA E KONCESIONIT, LEJA E TREGTIMIT, AUTORIZIMET DHE PROCEDURA E DHENIES SE TYRE

Neni 17

Personat juridike qe ushtrojnë veprimtari te përpunimit, transportimit dhe tregtimit te naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve te tyre, përpara fillimit te ushtrimit te veprimtarisë përkatëse janë te detyruar te pajisen me leje koncesioni, leje tregtimi ose autorizimi.

Neni 18

Leja e koncesionit

1. *Leja e koncesionit u jepet personave juridike, te parashikuar ne pikat "a" dhe "b" te nenit 11 te këtij ligji.* (i shfuqizuar)
2. Leja e koncesionit jepet me vendim te Këshillit te Ministrave përpara fillimit te punimeve për ndërtimin e instalimeve, për një periudhe deri ne 30 vjet me te drejte përsëritjeje.

Neni 19

Leja e tregtimit

1. Leja e tregtimit u jepet personave juridike te parashikuar ne piken "c" te nenit 11 te këtij ligji, te cilët ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit te naftës dhe gazit dhe nënprodukteve te tyre, për kategoritë përkatëse, te parashikuara ne nenin 10.
2. Lejet e tregtimit ndahen ne tri lloje, si vijon:
 - a. leja e tregtimit, e llojit A:
Leje tregtimi për shoqëritë qe tregtojnë produkte te kategorisë 0, II, III, IV dhe V, me përjashtim te nënprodukteve qe destinohen për furnizimin e mjeteve te fluturimit ajror.
 - b. leja e tregtimit, e llojit B:
Leje tregtimi për shoqëritë qe tregtojnë produkte te kategorisë I (gaz i lëngshëm).
 - c. leja e tregtimit, e llojit C:
Leje tregtimi për shoqëritë qe tregtojnë karburante për mjetet e fluturimit ajror.

3. Lejet e tregtimit te llojit A, B, C jepen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, sipas kriterëve dhe procedurave te parashikuara ne kete ligj dhe te akteve nënligjore te nxjerra ne baze dhe për zbatim te tij nga Këshilli i Ministrave.

4. **Lejet e tregtimit jepen me afat 10 vjet me te drejte rinovimi.**

Neni 20 Autorizimet

1. Autorizimet u jepen personave juridike, te parashikuar ne pikat "ç" dhe "d", te nenit 11 te këtij ligji, te cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes se karburanteve) dhe për shitjen e lendeve djegëse (njësitë e shitjes se lendeve djegëse).

2. Autorizimet për personat juridike, qe ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara ne pikat "ç" dhe "d" te nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhe deri ne 5 vjet me te drejte përsëritjeje.

3. Autorizimet për personat juridike, qe ushtrojnë veprimtarinë e stacionit te karburanteve te ndërtuara ne autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhe deri ne 10 vjet, me te drejte përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 21 Kushtet e dhënies se lejeve te tregtimit

Personat juridike, qe paraqesin kërkesë për leje tregtimi sipas nenit 19 te këtij ligji, janë te detyruar te plotësojnë **kushtin e kapitalit minimal te shoqërisë** dhe atë te **kapacitetit te depozitimit ne instalimet** prone te saj ose te marra ne përdorim me kontrate, për një periudhe kohe te barabarte me atë te vlefshmërisë se lejes se tregtimit. Kushtet e dhënies se lejes se tregtimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Kushti i kapitalit minimal duhet te jete i specifikuar sipas llojit te lejes se kërkuar, ndërsa kushti i kapacitetit te depozitimit te jete i specifikuar, sipas llojit te lejes dhe kategorisë se produkteve qe tregtojnë.

KREU IV KONTROLLI MBI PERSONAT JURIDIKE, QE USHTROJNE VEPRIMTARI TE PERPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TE NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE

Neni 22

Shteti organizon dhe ushtron kontroll ne personat juridike qe veprojnë ne fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit te naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre. Drejtimet kryesore te këtij kontrolli janë :

- Respektimi i normave teknike dhe i masave te mbrojtjes nga zjarri ne instalimet, impiantet dhe pajisje qe përdoren nga persona juridike;
- respektimi i treguesve cilësore i standardeve ligjore dhe dispozitave te tjera ligjore e nënligjore, ne parandalimin e abuzimeve dhe falsifikimeve qe mund te kryhen nga persona juridike;
- respektimi i dispozitave ligjore e nënligjore, lidhur me rezultatet financiare dhe plotësimit te detyrimeve fiskale te personave juridike ndaj shtetit.

Neni 23

Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridike të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

Ne përbërje të këtij Inspektorati funksionon Laboratori Qendror i Kontrollit.

2. Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre përgjigjet për ushtrimin e kontrollit për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridike, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të respektojnë normat teknike të masave mbrojtëse ndaj zjarrit, treguesit cilësorë, standardet shtetërore dhe dispozitat ligjore e nënligjore, me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe falsifikimeve që mund të kryhen. Për realizimin e këtyre detyrave ai bashkëpunon me organet e tjera shtetërore.

Rregullat për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 24

Kontrolli nga organet doganore dhe tatimore

Ministria e Financave, me strukturat e saj të organeve tatimore e doganore, organizon dhe ushtron kontroll ndaj personave juridike që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore, që lidhen me rezultatin financiar të tyre dhe plotësimin e detyrimeve fiskale e doganore ndaj shtetit, për kontrollin e treguesve cilësorë e sasiorë, si dhe të normave të tjera ligjore e nënligjore për parandalimin e abuzimeve e falsifikimeve, që nga çasti i hyrjes së mallit në pikat doganore, deri në procesin përfundimtar të shitjes së tyre.

Neni 25

Sanksionet

Veprimtaria e personave juridike që shkel dispozitat e këtij ligji, në rast se nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobe si vijon:

a) Për shkelje të nenit 8 masa e gjobës është nga 30 000 leke deri në 50 000 leke.

b) Për mosrespektim të sasisë së rezervës së sigurisë dhe afateve të plotësimit të tyre, sipas nenit 9, masa e gjobës është deri në 50 për qind të vlerës së sasisë së produktit, që mungon nga kuota e përcaktuar si rezerve sigurie.

c) Për shkelje të nenit 12 pika 5, masa e gjobës është nga 800 000 leke deri në 1 000 000 leke.

ç) Për shkelje të nenit 14 pika 9, ku thuhet: "Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për markën e produktit dhe cilësinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre që tregtojnë", masa e gjobës është nga 500 000 leke deri në 700 000 leke.

d) Për shkelje të nenit 15 pika 3 paragrafi i parë, për secilin detyrim veç e veç dhe paragrafi i dytë për dorëzimin e marrëveshjes në afat, si dhe për piken 4 dhe piken 6, masa e gjobës është nga 300 000 leke deri në 500 000 leke.

dh) Për shkelje të nenit 16 pika 3, masa e gjobës është nga 100 000 leke deri në 200 000 leke.

e) Për mosrespektimin e normave teknike në instalimet, impiantet dhe pajisjet të cilat përdoren nga personat juridike, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji, masa e gjobës është:

- Për rafineritë e naftës, naftësjiellësit, gazsjiellësit nga 300 000 leke deri në 500 000 leke.

- Për shoqëritë e tregtimit me shumice nga 200 000 leke deri ne 400 000 leke.
- Për stacionet e shitjes se karburanteve dhe njësitë e shitjes se lendeve djegëse nga 100 000 leke deri ne 300 000 leke.

e) Ne rast kur ushtrohet veprimtari pa leje, konform dispozitave te këtij ligji, personi dënohet me gjobe nga 4 000 000 leke deri ne 5 000 000 leke.

Masa e gjobës se parashikuar ne shkronjën "a" dhe "b" te këtij neni jepet nga Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve, kurse te gjitha gjobat e tjera jepen nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit te Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve te tyre.

Ne rast përsëritjeje te shkeljeve te mësipërme organi kompetent ka te drejtën e heqjes se lejes se koncesionit, te tregtimit apo autorizimit përkatës për ushtrimin e veprimtarisë.

Ankimi kundër vendimit te dënimit me gjobe behet ne përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligjin nr.7697, date 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 26

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2326, date 3.3.1999 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë,
Rexhep Meidani